



Gender Alliance for Development Center
Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim



Monitorim i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore

Bashkia Vlorë

VITI 2019

Tabela e Përmbajtjes

MONITORIMI I QËLLIMIT TË III-TË STRATEGJIK TË STRATEGJISË KOMBËTARE DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR BARAZI GJINORE 2016-2020	3
GJETJET KRYESORE	3
TË DHËNA STATISTIKORE NË LIDHJE ME RAPORTIMIN E DHUNËS NË FAMILJE NË BASHKINË VLORE.....	4
OBJEKTIVI 3.1 NDËRGJEGJËSIMI I SHOQËRISË PËR TË MOS PRANUAR DHE PËR TË MOS TOLERUAR USHTRIMIN E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.....	6
OBJEKTIVI 3.2: FUQIZIMI I MEKANIZMAVE TË REFERIMIT SI DHE SHTIMI/PËRMIRËSIMI I SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE TË SPECIALIZUARA PËR MBROJTJEN DHE TRAJTIMIN E RASTEVE TË DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE DHUNËS NË FAMILJE.	11
OBJEKTIVI 3.3: NDËSHKIMI I DHUNUESVE DHE DHËNIA E MUNDËSISË PËR REHABILITIMIN E TYRE, PËRMES PRORAMEVE TË SPECIALIZUARA.	22
REKOMANDIME.....	23

Monitorimi i Qëllimit të III-të Strategjik të Strategjisë Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Barazi Gjinore 2016-2020

Informacioni më poshtë i referohet gjetjeve të monitorimit të zbatimit të Strategjisë gjatë vitit 2019.

Gjetjet kryesore

- Përgjatë vitit 2019 sipas statistikave të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për Komisaratin Qendër Vlorë janë evidentuar 283 raste të dhunës në familje me 206 persona të dëmtuar.
- Në bazë të statistikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë për vitin 2019, sa i përket urdhërave të mbrojtjes, janë paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Rrethit Vlorë 194 kërkesa për urdhëra mbrojtje të reja, prej të cilave 20 kërkesa për Urdhëra Mbrojtje dhe 174 kërkesa për Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje
- Sipas të dhënave të përfuara nga bashkia Vlorë, gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, janë evidentuar dhe trajtuar në total 310 raste viktime të dhunës në familje.
- Përgjatë vitit 2019, në total u realizuan 43 aktivitete ndërgjegjësuese të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me gjithë aktorët që punojnë në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Vlorë. Përgjatë këtyre aktiviteteve u informuan rreth 1200 nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme dhe 400 studentë të qytetit të Vlorës dhe 12 njësi të saj administrative; u informuan rreth 200 anëtarë të komunitetit në qytetin e Vlorës dhe 12 njësitë e saj administrative.
- Në kuadër të manaxhimit rast pas rasti të viktimave të dhunës dhe grupeve të tjera të marxhinalizuara, bashkia Vlorë po implementon që prej janar 2019 Projektin Rajonal për Respektimin e të Drejtave Sociale të Grupeve të Margjinalizuara (SoRi), me mbështetjen financiare të INPO, German Cooperation dhe GIZ, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të Grupit Multidisiplinar për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje.
- Përgjatë vitit 2019 MRR në Bashkinë Vlorë nuk ka realizuar mbledhje të Komitetit Drejtues.
- Janë organizuar 6 mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar ku janë diskutuar dhe marrë vendime për 12 raste viktime të dhunës në familje. Mbledhjet e GTN-së janë realizuar në përputhje me problematikat e çdo rasti të trajtuar.
- Mungon bashkëpunimi me Zyrën e Përmbartimit, Spitalin e Përgjithshëm Vlorë dhe Mjekun Ligjor.
- Mungojnë trajnimet e përbashkëta të anëtarëve të MKR Vlorë të organizuara nga bashkia. Të vetmet trajnime ku specialistë të GTN kanë marrë pjesë janë ato të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile.
- Ndërkohë që paga e koordinatorës përbën përqindjen e buxhetit vjetor që mbështet qendrueshmërinë e këtij pozicioni. Nuk është alokuar në buxhetin e Bashkisë së Vlorës asnjë mundësi tjetër financiare për të mbështetur materiale promovuese.

- Nga data 1 Nëntor 2019, pranë Klinikës Ligjore të Qendrës Psiko-sociale “Vatra” ofrohet shërbim për këshillim të burrave dhe djemve dhunues. Ky shërbim u ofrohet të gjithë burrave dhe djemve që kanë ushtruar dhunë fizike, psikologjike apo seksuale në familje.
- Përgjatë vitit 2019 kjo zyrë rajonale e përmbarimit ka egzekutuar 5 raste me objekt “UMM” raste që kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbarimit, Nuk kanë qenë prezent në asnjë takim, situatë kjo e njëjtë edhe me vitet e kaluara.

Të dhëna statistikore në lidhje me raportimin e dhunës në familje në Bashkinë Vlorë

Të dhënat statistikore nga Drejtoria e Policisë Vlorë¹

Seksioni për Mbrojtjen e të Miturve dhe Dhunën në Familje është strukturë administrative dhe operacionale në Polici, përgjegjëse për të marrë të gjitha masat për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje dhe mbrojtjen e të miturve. Kjo strukturë ka në përbërje vetëm 1 punonjës dhe ka përgjegjësinë të mbikëqyrë, monitorojë dhe koordinojë punën me strukturat lokale për hetimin dhe parandalimin e krimeve, për të identifikuar dhe për t’iu përgjigjur rasteve të dhunës në familje. Gjithashtu, inspektorët e zonës dhe/ose specialistët për hetimin e krimeve, të cilët janë pjesë e seksionit të Hetimit dhe Parandalimit të Krimeve, merren edhe me çështjet e dhunës në familje.

Përgjatë vitit 2019 sipas statistikave të nxjerra nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë për Komisaratin Qendër Vlorë janë evidentuar 283 raste të dhunës në familje me 206 persona të dëmtuar. *(Numri i të dëmtuarve është më i madh se sa rastet e evidentuara, pasi në një vepër penale apo kërkesë padi për Urdhër Mbrojtje mund të jenë më shumë se një i dëmtuar.)* Nga rastet e evidentuara 217 ishin gra dhe vajza dhe 168 ishin kërkesat për Urdhër Mbrojtje.

Ndërkohë 78 raste u evidentuan si vepra penale të dhunës në familje sipas kodit 130/a me 26 persona të arrestuar. Detaje më të hollësishme pasqyrohen në tabelën vijuese:

¹ Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Tabela 1. Dhuna në familje në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë

Përshkrimi	Komisariati Vlorë
Evidentuar	283
Të dëmtuar gjithsej	296
Prej tyre gra/vajza	217
K-P.U.Mbrojtje	168
Sh.U.Mbrojtjes	11
V. P. Neni 130/a	78
Arrest. për 130/a	26
Ndaluar për 130/a	5
Gjendje të Lirë për 130/a	50
Në kërkim për 130/a	3
Autorë të vetëvrarë	0

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Të dhënat statistikore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë²

Në bazë të statistikave të Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Vlorë për vitin 2019, sa i përket urdhërave të mbrojtjes, janë paraqitur pranë Gjykatës së Shkallës së parë të Rrethit Vlorë 194 kërkesa për urdhëra mbrojtje të reja, prej të cilave 20 kërkesa për Urdhëra Mbrojtje dhe 174 kërkesa për Urdhëra të Menjëhershëm Mbrojtje. Këtyre kërkesave gjykata u është përgjigjur me lëshimin e 132 urdhërave sipas neneve përkatëse, 37 të pushuar dhe 22 janë rrezuar. Nga numri total i kërkesave janë perfunduar 183 të tilla dhe kanë mbetur pa përfunduar 11 prej tyre. Pranë gjykatës së shkallës së parë nuk janë paraqitur për ankim raste për urdhër të menjëhershëm mbrojtje.

Duhet theksuar se ka një shpërndarje pothuajse të barabartë të kërkesave të reja për urdhër mbrojtje në 6-mujorin e parë dhe 6-mujorin e dytë të vitit 2019, specifikisht 90 kërkesa në 6-mujorin e parë dhe 104 kërkesa në 6-mujorin e dytë.

Të dhënat statistikore nga Mekanizmi i Referimit – bashkia Vlorë³

Sipas të dhënave të përfuara nga bashkia Vlorë, gjatë periudhës janar – dhjetor 2019, janë evidentuar dhe trajtuar në total 310 raste viktime të dhunës në familje.

Gjatë vitit 2019 vihet re një rritje e lehtë e numrit të viktimave të dhunës të trajtuara nga bashkia. Ajo që bie në sy krahasuar me vitin 2018 është ngjashmëria sa i përket vendbanimit të viktimës me rreth 75% raste brenda në qytet dhe 25% në zonat rurale.

² Burimi: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë

³ Burimi: Bashkia Vlorë

Objektivi 3.1 Ndërgjegjësimi i shoqërisë për të mos pranuar dhe për të mos toleruar ushtrimin e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Bashkia Vlorë është përfshirë aktivisht në implementimin dhe realizimin e një kalendari të përbashkët aktivitetesh sensibilizuese në rrethin e Vlorës në kuadër të fushatave kombëtare dhe ndërkombëtare ndërgjegjësuere kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe dhunës në familje/me bazë gjinore. Strategjia që bashkia ndjek për ndërgjegjësimin e komunitetit për përmbushjen e objektivit 3.1 konsiston në angazhimin dhe në organizimin e fushatave-sesioneve sensibilizuese me qëllim rritjen e nivelit të informimit të fëmijëve, të rinjve, grave dhe burrave. Me këtë qëllim, që prej vitit 2011 bashkia Vlorë ka instaluar një linjë telefonike rajonale 24-orëshe, e cila krijon lidhje me njësitë lokale, policinë, urgjencat mjekësore dhe OJF-të, duke vendosur në këtë mënyrë edhe koordinimin ndër-institucional.

Koordinatorja vendore i dhunës (Zyra e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale) dhe Qendra Vatra kanë luajtur rol të rëndësishëm në iniciimin dhe koordinimin e kalendarit të aktiviteteve të përbashkëta gjatë 16 Ditëve të Aktivizimit Kundër Dhunës me Bazë Gjinore 25 nëntor – 10 dhjetor 2019. Aktorët që morën pjesë në takim ishin: Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, Bashkia Vlorë, Shërbimi Social Rajonal, Drejtorja e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Drejtorja Rajonale e Shëndetit Publik, Drejtorja e Policisë Vendoree, Zyra e Përmbartimit, Qendra Aulona, Qendra Për Zhvillim dhe Promovim Social dhe Qendra Me Komunitetin për Ndryshim.

Gjatë periudhës së 16 Ditëve të Aktivizimit, Njësia e dhunës në familje ka bashkëpunuar ngushtë me shkolla publike dhe universitete jopublike për sesione sensibilizuese dhe informuese me nxënës e të rinj për çështjet e barazisë gjinore dhe dhunës në familje poashtu edhe me ojf dhe profesionistë të fushave e disiplinave të ndryshme si pjesë e grupit teknik multidisiplinar.

Koordinatorja Vendore i Dhunës dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, inicioi dhe zhvilloi 4 seanca informuese në shkolla publike mbi temën “*Dhuna seksuale me të mitur*”.

Megjithatë, nuk ka qenë e mundur të organizohen aktivitete me shkallë të gjerë pjesëmarrësish nga komuniteti për shkak të mungesës së fondeve, mungesës së burimeve njerëzore dhe logjistikës. Përveç kësaj, mbledhja e komunitetit në një aktivitet të mirëkoordinuar dhe motivimi i tyre për të marrë pjesë në këto aktivitete, është një sfidë e cila vijon të mos realizohet.

Për aktivitetet sensibilizuese në shkolla nuk janë shpenzuar fonde. Aktivitetet kanë konsistuar në informimin me gojë të nxënësve për fenomenin e dhunës. Mungon prodhimi i posterave sensibilizues apo broshurave informuese për çështjet e dhunës me financim të bashkisë. Kjo është realizuar nga organizatat e shoqërisë civile që operojnë në territorin e bashkisë Vlorë dhe punojnë në këtë fushë.

OSHC-të që punojnë në lidhje me dhunën me bazë gjinore në territorin e bashkisë Vlorë:

- 1- Qendra Psiko-sociale “Vatra”
- 2- Qendra “Aulona”

- 3- “Me komunitetin për Ndryshim”
- 4- Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social, QZHPS
- 5- Qendra Rinore e Vlorës

Përgjatë vitit 2019, në total u realizuan 43 aktivitete ndërgjegjësuere të organizuara në bashkëpunim të ngushtë me gjithë aktorët që punojnë në fushën e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore në Vlorë. Përgjatë këtyre aktiviteteve u informuan rreth 1200 nxënës të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme dhe 400 studentë të qytetit të Vlorës dhe 12 njësite të saj administrative; u informuan rreth 200 anëtarë të komunitetit në qytetin e Vlorës dhe 12 njësitë e saj administrative.

Gjithashtu u realizuan 3 aktivitete publike ndërgjegjësuere ku u shpërndanë rreth 2000 broshura informuese, 130 bluza, 600 stilolapsa me slogan kundër dhunës në familje dhe një video sensibilizuese për rreth 850 qytetarë paralelisht 2 biseda në radio mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore;

Tabela 2. Tabela e aktiviteteve kundër dhunës me bazë gjinore dhe datat e realizimit të tyre

Nr	Data	Vendi	Tema	Organizuar nga:
1	Shkurt 2019	Babicë e Madhe, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Vlorë	“Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe Ligjin “Për Gjendjen Civile”	Qendra Psiko – Sociale “Vatra”; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI
2	Shkurt 2019	shkolla 9 vjeçare “Muço Delo” Vlorë	“Të Drejtat e Fëmijëve” dhe Kodin Penal të Drejtësisë për të mitur	Qendra Psiko – Sociale “Vatra”; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI
3	8 mars 2019	Vlorë	Protesta nën sloganin #megratëdhëpërgratëNë kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Gruas	Qendra “Vatra” në bashkëpunim me Qendra “Aulona”, Qendra Rinore e Vlorës, Eorld Vision, Shërbimi Social Rajonal dhe mediat lokale.
4	15 Mars 2019	Babicë e Madhe, Vlorë	Sesion informues me vajza dhe gra të komunitetit	Qendra Psiko – Sociale “Vatra”; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI
5	Mars 2019	Vlorë	Trajnim me studentë "Legjislacioni kombëtar dhe ndërkombëtar mbi dhunën në familje dhe dhunën me bazë gjinore.”	Qendra Psiko – Sociale “Vatra”; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI

6	28 Mars 2019	Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë	Forum me temë "Mbrotjtja e fëmijëve viktimave të dhunës në familje dhe abuzimit. Instrumentat ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar"	Qendra Psiko – Sociale "Vatra"; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI
7	Mars 2019	OneTV Vlora	Bisedë me temë "Funksionimi i Mekanizmit Rajonal të Referimit dhe Trajtimit të viktimave të dhunës në familje në bashkinë Vlorë"	Qendra "Vatra" në bashkëpunim Qendrën "Aleanca Gjinore për Zhvillim" në Tiranë
7	Maj 2019	Vlorë	Prodhim dhe publikim i materialeve sensibilizuese (një banner, 75 bluza, 600 stilolapsa me slogan kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore dhe 2000 fletë informuese)	"Vatra"; Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida); Terre des hommes në Shqipëri dhe ANTTARC
8	Maj, Qershor, Korrik, Shtator 2019	Vlorë dhe njësitë e saj administrative	12 sesione informuese me nxënës "Shkaqet dhe pasojat sociale të dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore"	"Vatra"; Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida)
20	20 qershor 2019	Radio Valë e Kaltër, Vlorë	Bisedë me temë "Efektet e dhunës ndaj të miturve"	Qendra Psiko – Sociale "Vatra"; Save the Children in Albania, në partneritet me QSHPLI
21	22 korrik 2019	Vlorë	Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të stafit social të qendrës Vatra për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje	"Vatra"; Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim (Sida)
22	Shtator 2019	Njësia administrative Qendër, Bashkia Vlorë	Shkaqet dhe pasojat sociale të dhunës në familje. Legjislacioni dhe mekanizmat mbrojtës të viktimave të dhunës	Qendra Psiko – Sociale "Vatra"; SIDA; FCG SWEDEN
23	Shtator 2019	Njësia administrative Novoselë, Bashkia	Shkaqet dhe pasojat sociale të dhunës në familje. Legjislacioni dhe	Qendra Psiko – Sociale "Vatra"; SIDA; FCG SWEDEN

		Vlorë	mekanizmat mbrojtës të viktimave të dhunës	
24	Tetor 2019	Bashkia Selenicë	Seancë informuese me komunitetin	Qendra Vatra
25	8 Nëntor 2019	Qendra “Vatra”	Takim koordinuesi aktorëve lokal shtetëror dhe organizatave të shoqërisë civile për ngritjen dhe planifikimin e aktiviteteve sensibilizuese për 16 Ditët e Dhunës	Drejtoria Vendoree të Policisë, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Qendra “Aulona”, Drejtoria Rajonale të Shëndetit Publik, Koordinatorja Vendore i Dhunës pranë bashkisë Vlorë dhe Qendra “Me Komunitetin për Ndryshim”
26	20 Nëntor 2019	Vlorë	Aktiviteti publik ndërgjegjësues në Ditën Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve	“Me Komunitetin për Ndryshim”, Njësia e Dhunës në Familje dhe Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, institucione lokale shtetërore, organizata të shoqërisë civile, institucione arsimore dhe nxënës të shkollave.
27	25 Nëntor 2019	Shkolla “Avni Rustemi”	Seancë informuese me nxënës	Koordinatorja vendore dhe NJMF, Vatra, Prefekti i Qarkut
28	25 Nëntor 2019	Shkolla “Mustafa Qemal Ataturku”	Seancë informuese me nxënës	Qendra Vatra
29	25 Nëntor 2019	Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë	Sesion informues me studentë të Juridikut	Qendra Vatra, bashkia, Policia Vlorë, Drejtoria Rajonale e Shëndetit
30	27 Nëntor 2019	Shkolla “Ismail Qemali”	Seancë informuese me nxënës	Koordinatorja vendore dhe NJMF
31	29 Nëntor 2019	Shkolla Jopublike “Elite”	Seancë informuese me nxënës	Koordinatorja vendore, Policia, Qendra Rinore e Vlorës
32	Nëntor - Dhjetor	Qendra Vatra	Prodhim dhe shpërndarje e materialeve informuese	Qendra Vatra
33	Dhjetor 2019	Vlorë - MaxiLed	Prodhim dhe publikim i një videoje sensibilizuese me angazhimin e drejtuesve të institucioneve shtetërore vendoree dhe institucione fetare	Qendra Vatra, Qendra “Aulona” Prefektura e Qarkut Vlorë; Këshilli i Qarkut Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror; Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë; Drejtoria Rajonale e Formimit Profesional Publik Vlorë; Drejtoria Rajonale e Kujdesit Shëndetësor Vlorë;

				ÇRSP Apostolik i Shqipërisë së Jugut; Kisha Biblike Baptiste e Vlorës/Vëllazeria Ungjillore e Krishterë; Myftnia e Rrethit Vlorë dhe Kisha Ortodokse Vlorë
34	4 dhjetor 2019	Shkolla Todi Koceli dhe bashkia Selenicë	2 sesione informuese me nxënës dhe me komunitetin	Qendra Vatra
36	5 dhjetor 2019	Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Vlorë	Takim informues me Specialistë të Policisë	Qendra Vatra
37	5 dhjetor 2019	Shkolla Ali Demi, Vlorë	Seancë informuese me nxënës	Qendra Vatra
38	6 dhjetor 2019	Shkolla "Qazim Pali" Borsh dhe bashkia Himarë	2 sesione informuese me nxënës dhe me komunitetin	Qendra Vatra
40	10 dhjetor 2019	Shkolla "Halim Xhelo" Vlorë	Seancë informuese me nxënës	Koordinatorja vendore dhe NJMF
41	17 dhjetor 2019	Shkolla Muhamer Janina, Ura Vajgurore	Sesion informues me nxënës	Qendra Vatra
42	20 dhjetor	Shkolla Jopublike NR1, Vlorë	Sesion informues me nxënës	Qendra Vatra
43	Janar-Dhjetor 2019	Ëëbsite, facebook, instagram	Fushatë ndërgjegjësimi në rrjete sociale	Qendra Vatra, Aulona, Me komunitetin për ndryshim, QZHPS, SHSSH, QFP, etj

Në kuadër të aktiviteteve në 31 tetor 2019 - Pranë zyrave të Qendrës "Vatra" u zhvillua një tryezë diskutimi rreth sfidave dhe vështirësive me të cilat ndeshen organizatat e shoqërisë civile që punojnë në mbështetje të viktimave të dhunës. Ttryeza u organizua me nismën e znj. Erinda Ballanca, Avokate e Popullit dhe përfaqesues të Rrjetit të Fuqizimit të Gruas AWEN si dhe përfaqesues të organizatave të shoqërisë civile në Vlorë (Qendra "Vatra", Qendra "Aulona", "Me komunitetin për ndryshim", World Vision, Qendra Rinore e Vlorës, Qendra Burimore Rajonale për organizatat e shoqërisë civile dhe Qendra për Zhvillim dhe Promovim Social).

Në kuadër të hartimit dhe miratimit të Planit Social dhe ngritjes së Grupit të Dialogut Social, si mekanizëm i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit midis ofruesve të shërbimeve publike dhe jo publike dhe viktimave të dhunës, bashkia Vlorë organizoi një takim konsultativ. Takimi u realizua datë 13 shkurt. Takimi u ndoq nga takime të rregullta gjatë gjithë vitit. Grupi i Dialogut Social GDS është një iniciativë e mbështetur nga UNICEF dhe qëllimi i këtij grupi është diskutimi, mbledhja e informacionit dhe dalja me disa prioritete që i përkasin çështjeve sociale për të cilat do të llobohet në Bashkinë Vlorë. Gjatë takimeve në vijim pritjet të konkretizohen këto prioritete dhe ti drejtohen kryetarit të bashkisë Vlorë, si prioritete mbi të cilat duhet të fokusohet puna e bashkisë mbi çështjet sociale.

Në kuadër të manaxhimit rast pas rasti të viktimave të dhunës dhe grupeve të tjera të marxhinalizuara, bashkia Vlorë po implementon që prej janar 2019 Projektin Rajonal për Respektimin e të Drejtave Sociale të Grupeve të Margjinalizuara (SoRi), me mbështetjen financiare të INPO, German Cooperation dhe GIZ, me qëllim ngritjen e kapaciteteve të Grupit Multidisiplinar për Trajtimin e Viktimave të Dhunës në Familje. Specialistë anëtarë të GTN janë trajnuar mbi temat:

- “Të drejtat sociale dhe realizimi i tyre tek grupet e marxhinalizuara”, 8 shkurt 2019
- Vizitë studimore “Fuqizimi i përfshirjes së zyrtarëve komunal në ofrimin e shërbimeve sociale dhe komunitare”, 26 shkurt 2019
- “Grupet lëvizëse dhe puna arritëse në komunitet”, 13 mars 2019
- “Grupet lëvizëse dhe puna arritëse në komunitet”, 19 mars 2019

Në 4 trajnimet e zhvilluara kanë marrë pjesë përfaqësues nga: bashkia Vlorë, koordinatori vendore i dhunës, Shërbimi Social Rajonal, Zyra e Punës Vlorë, Qendra “Vatra”, Drejtoria Arsimore Rajonale, Policia, Qendra Aulona dhe Drejtoria e Shëndetit Publik.

12 – 14 qershor 2019: Në kuadër të bashkëpunimit të rregulluar me Marrëveshjen për Mekanizmin Rajonal të Referimit dhe Trajtimin të Viktimave të Dhunës në bashkinë Vlorë, anëtarë të GTN (specialistë nga bashkia Vlorë, koordinatori vendore i dhunës, specialistë nga Qendra Vatra, specialistë nga Zyra Rajonale e Punës) ishin pjesë e grupit të Vizitës për Shkëmbimin e Eksperiencave midis Grupit Teknik Ndërsektorial të bashkisë Vlorë dhe asaj së Mitrovicës dhe Prishtinës, në Kosovë.

Në kuadër të punës advokuese në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore, dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, përgjatë muajit korrik, specialistë të Vatrës kanë marrë pjesë dhe kontribuar në Takimin e parë konsultativ për Strategjinë e Mbrojtjes Sociale 2019-2022, organizuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Vatra ishte pjesë e grupit të parë të punës për dhënien e komenteve dhe konsultimeve lidhur me hartimin e Strategjisë së Mbrojtjes Sociale 2019 – 2022. Organizatat e shoqërisë civile konsiderohen si pjesë e rëndësishme në ofrimin e shërbimeve direkte ndaj grupeve vulnerabël dhe njohjen e kontekstin ku zhvillohen problematikat e këtyre target-grupeve. Në vazhdim do të vijohet me takime të tjera për finalizimin e Strategjisë.

Gjatë vitit 2019, përfaqësues të institucioneve fetare në Vlorë bashkëpunuan dhe i'u përgjigjën pozitivisht ftesës së Qendrës “Vatra” dhe “Aulona” në bashkëpunim me bashkinë për kontributin në realizimin e videos sensibilizuese “Gratë nuk janë vetëm në luftën kundër dhunës”, video ku u lançuan mesazhe ndërgjegjësuese edhe nga përfaqësues burra të institucioneve fetare. Nëpërmjet kësaj iniciative, u vendosën urat e para të bashkëpunimit me këto institucione.

Objektivi 3.2: Fuqizimi i mekanizmave të referimit si dhe shtimi/përmirësimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për mbrojtjen dhe trajtimin e rasteve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

Mekanizmi Rajonal i Referimit (MRR) në Bashkinë Vlorë funksionon në bazë të marrëveshjes së nënshkruar që prej vitit 2011. Në funksion të ngritjes dhe mirëfunksionimit të Mekanizmit të Referimit, vazhdon të jetë funksionale përgjatë viteve, Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Bashkisë Vlorë dhe Drejtorisë së Policisë Qarkut Vlorë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë, Prokuroria e rrethit Vlorë, Zyra e Përmbartimit Vlorë, Mjeku Ligjor, Drejtoria e Shëndetit Publik Vlorë, Spitalit të Përgjithshëm Vlorë, Drejtoria e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë, Zyra e Punësimit Vlorë, Qendra Psiko-Sociale “Vatra”, e datës 22.02.2011.

Përgjatë vitit 2019 MRR në Bashkinë Vlorë nuk ka realizuar mbledhje të Komitetit Drejtues.

Përgjatë periudhës janar – dhjetor 2019, koordinatoresha vendore si boshti i mekanizmit të referimit ka trajtuar 310 raste viktime të dhunës në familje. Rastet janë kontaktuar në momentin e parë që koordinatoresha vendore është vendosur me dijeni nga Gjykata, Policia apo institucione të tjerë referuese. Të gjitha rastet janë këshilluar nëpërmjet takimeve direkte dhe komunikimeve nëpërmjet telefonit, është realizuar vlerësimi i nevojave; janë informuar përfitueset mbi hartën e shërbimeve dhe janë referuar/ndërmjetësuar tek ofruesit e shërbimeve, në varësi të nevojave të identifikuar.

Janë organizuar 6 mbledhje të Grupit Teknik Ndërdisciplinar ku janë diskutuar dhe marrë vendime për 12 raste viktime të dhunës në familje. Mbledhjet e GTN-së janë realizuar në përputhje me problematikat e çdo rasti të trajtuar. Specialistët e GTN kanë ofruar shërbimet përkatëse të nevojshme për ndërhyrjen dhe manaxhimin e rasteve, si:

- strehim urgjent në qendra rezidenciale në bashkëpunim me Qendrën “Vatra”
- asistencë/këshillim ligjor dhe asistencë/këshillime psikologjike pa pagesë në bashkëpunim me Klinikën Ligjore të Qendrës “Vatra”
- mbështetje financiare nëpërmjet paketave ushqimore në bashkëpunim me Qendrën “Vatra” dhe organizata të tjera
- ndërmjetësim për formim profesional dhe punësim në bashkëpunim me Drejtorinë e Formimit Profesional dhe Zyrën e Punës
- ndërmjetësim për lehtësim në akses dhe ofrim shërbimesh
- mundësimi në kohë i certifikatave personale/familjare për rastet viktime të dhunës
- hartimi i kërkesë padive në bashkëpunim me Klinikën Ligjore të Qendrës “Vatra”
- Pajisje me mjete identifikimi në bashkëpunim me Klinikën Ligjore të Qendrës “Vatra”
- akomodim emergjent i fëmijëve në institucione të përkujdesit (Shtëpia e Foshnjës Vlorë)
- ndërmjetësim për akomodim në strehëza/qendra kombëtare rehabilituese,
- ndërmjetësim për përfshirje në skemën e ndihmës ekonomike,
- ndërmjetësim për ndjekje dhe frekuentim pa pagesë të kopështeve dhe cerdheve pa pagesë (me fondet e bashkisë)
- ndërmjetësim për përfshirje në skemat e strehimit social për viktimat e dhunës

Ashtu sikurse gjatë vitit 2018, edhe përgjatë vitit 2019 aktorët e GTN që marrin pjesë aktivisht në mbledhje janë: Policia, Qendra Vatra, Zyra Rajonale e Punësimit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Shëndetit Publik dhe Zyra Arsimore Rajonale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Prokuroria nuk janë prezent në mbledhje por bashkëpunimi me ta është i konsoliduar nëpërmjet rrugeve alternative të komunikimit (email, telefon). Bashkëpunimi konsiston në shkëmbimin e informacionit në kohë reale lidhur me rastet e pajisura me UM, UMM.

Ndërkohë mungon bashkëpunimi me Zyrën e Përmbarrimit, Spitalin e Përgjithshëm Vlorë dhe Mjekun Ligjor.

Si pikë e fortë e GTN vlen të përmendet qëndrueshmëria (mosndërrimi i shpeshtë) e specialistëve që përfaqësojnë institucionet në këto mbledhje dhe prania (ushtrimi i aktivitetit) e organizatave joqeveritare të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Gjatë vitit 2019, koordinatoresha ka thirrur 2 mbledhje të GTN për të ndarë informacion mbi rastet e trajtuara dhe sfidat. I njëjti informacion është përcjellë tek anëtarët e MKR nëpërmjet dy raporteve, rezultate dhe sfida të hasura gjatë manaxhimit dhe trajtimit të rasteve të trajtuara gjatë periudhës së raportimit.

Në lidhje me shpeshtësinë e përdorimit të sistemit dhe përditësimit të të dhënave, ato hidhen rregullisht. Përdorimi i sistemit REVALB është sistematik dhe koordinatoresha sigurohet që në fund të çdo muaji të gjitha rastet të jenë të evidentuara.

Numri i rasteve të trajtuara me sukses në 2019

Gjatë vitit 2019, janë trajtuar me sukses në bashkëpunim të ngushtë me Qendrën Vatra, Zyrën Rajonale të Punësimit, Drejtorinë e Policisë Vlorë dhe bashkinë Vlorë 12 raste gra viktime të dhunës në familje. Për secilin prej rasteve është realizuar vlerësimi i nevojave në familje dhe janë informuar për hartën e shërbimeve. Bazuar në nevojat e vlerësuar, përfitueset janë referuar dhe ndërmjetësuar për shërbime pranë aktorëve. Rastet e mësipërme janë ndërmjetësuar për:

- strehim emergjent i sigurt pranë Qendrës Vatra;
- shërbim ligjor dhe psikologjik (për rastin dhe fëmijët) pranë Klinikës Ligjore të Qendrës Vatra;
- vlerësim për mbështetje me apartament me qera, paketa ushqimore, medikamente, mjete shkollore etj, pranë Qendrës “Vatra”;
- regjistrim si punë-kërkues aktiv dhe punësim pranë Zyrës Rajonale të Punësimit;
- regjistrim pa pagese për formim profesional pranë Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional;
- aplikim për përfitim nga skema e strehimit social në bashki;
- aplikim për përfitim të ndihmës ekonomike në bashki, etj.

Rast Suksesi: Gjatë muajit maj të vitit 2019, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë ka referuar pranë koordinatoreshat vendore të dhunës një përfituese e pajisur gjatë asaj kohe me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje. Pasi është kontaktuar me përfituesen, koordinatoresha vendore dhe një punonjës social i Qendrës “Vatra” realizuan vlerësimin e nevojave në familje. Përfituesja M.B dhe dy fëmijët e saj jetonin në një banesë me qera në qytetin e Vlorës në kushte të vështira. Rasti ishte paraqitur gjatë ditëve të para të muajit maj në polici ku kallëzoi dhunën fizike dhe psikologjike që ish-bashkëshorti i saj ushtronte mbi të dhe ku u plotësua kërkesë-padia për

UMM. Bazuar në vlerësimin e nevojave të rastit, koordinatorja vendore mblodhi GTN, ku u shqyrtua rasti dhe u diskutua mbi masat që duheshin marrë. Familja u mbështet gjatë periudhës maj – shtator 2019 nga programi i Qendrës Vatra me këshillime psikologjike, apartament me qera, paketa ushqimore, këshillim ligjor, medikamente për përfituesen dhe fëmijët dhe mjete shkollore për fëmijët. Koordinatorja e referoi rastin pranë Zyrës Rajonale për Punësim. Aktualisht familja paraqet proges. Përfituesja është e punësuar me kohë të pjesshme ndërkohë që fëmijët e mitur frekuentojnë shkollën. Krahasuar me kohën kur gruaja vendosi kontaktet e para me aktorët e lartë përmendur, gjendja e saj psikologjike është përmirësuar ndjeshëm. Mban kontakte të rregullta me koordinatorjan dhe Qendrën Psiko-Sociale Vatra.

Gjatë muajit janar 2019, me iniciativën e Drejtorisë së Ndihmës dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë, kjo drejtori dhe Vatra bashkëpunuan ngushtë dhe kontribuan për hartimin e listës së 15 fëmijëve që do të përfitojnë çerdhe dhe kopështin falas (nga të ardhurat e bashkisë). Lista u finalizua gjatë fillimit të muajit shkurt, me hartimin e Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 17, datë 18.02.2019. Nga ky shërbim përfituan në total 14 fëmijë, 7 fëmijë të vajzave dhe grave në situatë vulnerabël dhe 7 fëmijë të përfitueseve të Qendrës "Vatra", prej të cilëve 4 në moshë çerdhe dhe 10 në moshë kopështi. Të gjithë përfituesit janë kontaktuar dhe monitoruar në familje, janë pajisur me kopje të vendimit dhe kanë filluar frekuentimin e rregullt të kopështit dhe çerdes, që e ka vlefshmërinë për 9 muaj.

Kjo praktikë u ndoq edhe në fund të vitit, kur Qendra Vatra gjatë muajit nëntor, në bashkëpunim me bashkinë Vlorë dhe Këshillin Bashkiak të bashkisë Vlorë, hartoi dhe propozoi pranë këtij të fundit, listën e 9 fëmijëve që vijnë nga familje me problematika sociale për frekuentimin e çerdheve dhe kopështeve me të ardhurat e bashkisë gjatë vitit 2020. Iniciativa është ndërmarrë që prej vitit 2018 nga Aleanca e Grave të Këshillit Bashkiak Vlorë.

Gjatë fundit të vitit 2019, në bashkëpunim me Këshillin Bashkiak Vlorë, Vatra ka propozuar pranë bashkisë Vlorë listën e 5 grave viktime të dhunës në familje dhe 10 fëmijët e tyre për mbështetje me programe të strehimit social. Përfitueset janë në proces vlerësimi dhe dorëzimi dokumentacioni.

Bazuar në VKM nr.334, datë 17.2.2011, "Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij", pushteti vendore është autoriteti kryesor për drejtimin e komitetit drejtues, ekipit teknik ndërdisiplinor dhe përcaktimin e koordinatorjat vendore.

Pranë Bashkisë është emëruar Specialistja e lartë për Dhunën në Familje, e cila do të luajë rolin e Koordinatorës vendore. Znj. Rezarta Andoni, e emëruar në këtë pozicion, është e gatshme të informojë të gjitha institucionet/aktorët e interesuar përsa i takon sistemit të reagimit të koordinuar kundër dhunës në familje.

Pozicioni i koordinatorës vendore për bashkinë e Vlorës është krijuar në nëntor 2009 dhe detyrat janë kryer nga i njëjti person që prej emërimit të saj si Specialiste e Lartë për Dhunën në Familje, ku luan rolin e Koordinatorjat Vendore.

Detyrat e koordinatorjat vendore janë specifikuar edhe në Rregulloren e re të Bashkisë Vlorë, e rishikuar gjatë periudhës shtator-tetor të vitit 2017. Kjo rregullore është publikuar në faqen zyrtare të Bashkisë Vlorë.

Gjatë vitit 2019, koordinatorja ka marrë pjesë në:

- Trajnimin mbi Hartimin e projekteve me fokus social në kuadër të hartimit dhe implementimit të Planit Social në bashki, organizuar nga UNDP, me pjesëmarrjen e 9-të bashkive të vogla.
- Takimin e 2-të mbi Hartimit e Plan Lokal në lidhje me çështjet LGBT, organizuar nga Komiteti Hollandez i Helsinkit.
- Trajnimin me temë “Fëmijët janë të përkujdesur, të mbrojtur dhe marrin pjesë aktivisht në vendime që ndikojnë jetën e tyre, organizuar nga organizata “Me komunitetin për Ndryshim”, në Vlorë.

Mungojnë trajnimet e përbashkëta të anëtarëve të MKR Vlorë të organizuara nga bashkia. Të vetmet trajnime ku specialistë të GTN kanë marrë pjesë janë ato të organizuara nga organizatat e shoqërisë civile. Në kuadër të projektit “Familje e shëndetshme – fëmijë të shëndetshëm! Mbështetje multidisiplinare për fëmijët e viktimave të trafikimit dhe të dhunës në familje në Bashkinë Vlorë”, që është zbatuar nga Qendra Psiko-Sociale „Vatra“, përgjatë muajit qershor 2019 u zhvilluan 3 ditë trajnime me aktorë lokalë të mbrojtjes së viktimave të dhunës dhe fëmijëve në bashkinë Vlorë.

Temat e trajnuara gjatë serisë së trajnimeve të mësipërme:

11 Qershor 2019 - “Njohja dhe zbatimi i ligjit 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, si edhe VKM për zbatimin me efektivitet të Ligjit; përgjegjësitë e secilit aktor që rrjedh nga ky ligj”;

18 Qershor 2019 - “Menaxhim i rasteve: kuadri i procedurave të referimit dhe menaxhimit të rastit; planifikimi i ndërhyrjes, zbatimi i tij dhe monitorimi i rasteve, në përputhje me VKM 578”;

22 Qershor 2019 - “Identifikimi, referimi dhe mbrojtja Viktimave/viktima të mundshme trafikimi në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit për Mbrojtjen e Viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit; përgjegjësitë e secilit aktor që rrjedhin nga ky vendim”

Në ciklin e trajnimeve morën pjesë dhe u angazhuan 24 pjesëmarrës përfaqësues nga Grupi Teknik Ndërsektorial, psikologë dhe punonjës social të shkollave 9 vjeçare dhe të mesme të qytetit të Vlorës, si aktorë kyç në sistemin e referimit, identifikimit dhe mbrojtjes së fëmijëve. Trajnimet kanë pasur për qëllim fuqizimin e kapaciteteve të aktorëve përgjegjës për mbrojtjen e fëmijëve në drejtim të identifikimit, referimit, menaxhimit dhe mbrojtjes së rasteve të grave dhe fëmijëve të abuzuar, dhunuar, shfrytëzuar dhe trafikuar.

Ndërkohë që paga e koordinatorës përbën përqindjen e buxhetit vjetor që mbështet qendrueshmërinë e këtij pozicioni. Nuk është alokuar në buxhetin e Bashkisë së Vlorës asnjë mundësi tjetër financiare për të mbështetur materiale promovuese. Materialet promovuese (broshura, fletë-palosje, banera) janë prodhuar dhe shpërndarë nga organizata të shoqërisë civile,

në kuadër të programeve dhe projekteve që ato ndjekin dhe implementojnë. Gjithashtu, aktivitetet sensibilizuese të iniciuara nga Koordinatorja vendore (Bashkia) përgjatë datave 25 nëntor – 10 dhjetor 2019 janë aktivitete pa kosto financiar, kjo sepse nuk ka zë specifik në buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR.⁴

Bazuar në monitorimin por edhe intervistat me koordinatoren vendore, bashkëpunimi me Policinë është shumë i rëndësishëm në përgjigjen ndaj dhunës në familje, prej së cilës merret një informacion i plotë për rastet e ndodhura. Vazhdon rutina e përcjelljes së informacionit midis Seksionit të të Miturve dhe Dhunës në Familje dhe koordinatores vendore, mbi rastet viktime të dhunës të paraqitura pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë.

Që prej muajit mars 2018 midis Policisë dhe Drejtorisë së Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale në Bashkinë Vlorë është vendosur një marrëveshje bashkëpunimi në funksion të mirë-manaxhimit dhe zgjidhjes së rasteve. Nëpërmjet kësaj marrëveshjeje, DNESHSHS kërkon mundësimin e komunikatave mujore për shtyp të rasteve të dhunës për Bashkinë Vlorë dhe numrat e kontaktit për çdo rast dhune të paraqitur pranë DVPV.

Gjatë mbledhjeve të GTN specialistja e dhunës në familje pranë Policisë është gjithmonë prezente, duke luajtur rol aktiv në diskutimin, trajtimin dhe manaxhimin e rasteve. Gjithashtu, janë përfshirë aktivisht dhe kanë iniciuar zhvillimin e seanceve informuese në shkolla në ditë të caktuara që përputhen me fushata kombëtare apo ndërkombëtare.

Vlen të theksohet se gjatë procesit të hartimit të listës së 14 fëmijëve për frekuentimin e çerdheve dhe kopshteve me drekë, është kërkuar informacion i detajuar edhe nga Seksioni i Çështjeve të Dhunës në Familje dhe të Miturve në Drejtorinë Vendore të Policisë Vlorë, e cila ka siguruar të dhëna mbi familjen, të tilla si: adresën e vendbanimit, numra kontakti dhe informacion nëse nëna e fëmijës është pajisur me UM, UMM apo ka çështje të hapura penale. Pas sigurimit të këtyre të dhënave, janë realizuar verifikime nga Drejtoria e Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale nëpërmjet vizitave në familje.

Përgjatë vitit 2019, statistikave tregojnë se kërkesat për UM dhe UMM janë plotësuar të gjitha nga Drejtoria Vendore e Policisë. Kjo përbën risi krahasuar me vitet e kaluara, ku rastet që kërkonin të pajiseshin me UM/UMM i drejtoheshin organizatave jofitimprurëse.

Avantazhet lidhur me kapacitetet e DVP Vlorë lidhen me: punonjës të përkushtuar dhe të angazhuar, qëndrueshmëria e stafit, bashkëpunim i mirë i brendshëm, etj. Ndërkohë që një ndër pikat e dobëta lidhet me mungesën e psikologut dhe punonjësit social në nivel komisaritati.

Në lidhje me marrjen e informacionit në kohë apo momentin e ngjarjes për cdo rast dhune, koordinatori vendore kontaktohet me SPZ e zonave të bashkise Vlorë në momentin kur paraqitet pranë komisarariatit viktime e dhunës në familje për të bërë procedurat për kërkesë-padi për UMM.

Koordinatorja vendore ka arritur të ketë të gjitha numrat e kontakteve të SPZ nga të cilët siguron numrat e kontakteve për të komunikuar me viktimën dhe bën vlerësimin e nevojave ose

⁴ Burimi: Koordinatorja vendore

intervistimet përkatëse e më pas referon rastet në institucionet që ofrojnë shërbime sipas rastit të paraqitur. Koordinatorja vendore ka një bashkëpunim shumë të mirë me Policinë dhe Qendrën “Vatra” për identifikim referim dhe menaxhim rastesh të viktimave të dhunës. Cdo muaj specialistja e dhunës në familje dhe sektorit të të miturve i kalon me email komunikatat për shtyp për rastet e dhunës ku mëpas koordinatorja vendoree kontakton me SPZ të cilët kanë trajtuar rastet e ku merr paraprakisht edhe numrat e këtyre rasteve. Një mënyrë tjetër është kontakti me gjykatën nëpërmjet kancelares apo kryesekretares për numrat e kontakteve të viktimave të dhunës, po ashtu merr dhe statistika tre mujore, 6 mujore ose vjetore nga Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë.

Gjatë vitit 2019, janë referuar nga koordinatorja vendore pranë Zyrës Rajonale të Punësimit 93 vajza dhe gra viktime të dhunës në familje. Referimi është realizuar gjatë mbledhjeve të GTN ose nëpërmjet telefonit dhe email. Specialistë të ZRP janë gjithmonë prezent në mbledhjet e GTN-së.

Ndërkohë, Qendra Vatra ka referuar 32 vajza dhe gra viktime të dhunës në familje për punësim dhe regjistrim në kurse të formimit profesional pranë Zyrës Rajonale të Punësimit dhe Drejtorisë Rajonale të Formimit Profesional.

Sfidë mbetet kufizimi në oraret e punës jo-të favorshme dhe të përshtatshme për nëna me fëmijë dhe pagat e ulta etj. Megjithatë, duhet shpjeguar se sfidat lidhen ngushtësisht edhe me nivelin e ulët arsimor të viktimave, mospasjen ose të mospraktikuarin e një profesioni etj.

Koordinatorja vendore ka raportuar se ka bashkëpunim të mirë me Drejtorinë Arsimore Rajonale në aktivitete të përbashkëta me OJF-të dhe/ose aktorët e tjerë. Si fushë kryesore e bashkëpunimit kanë qenë aktivitetet për rritjen e ndërgjegjësimit në shkolla.

Zyra Arsimore Rajonale Vlorë i është përgjigjur në kohë kërkesave apo referimeve të rasteve të koordinatorjat vendore. Kanë qenë prezent dhe aktiv në mbledhjet e GTN për rastet kur është nevojitur ndërhyrja e tyre (regjistrim i fëmijëve të përfituesve në shkollë, ndërmjetësim për rifrekuentimin e shkollës, ndjekje e nxënësve me këshillime psiko-sociale nga Shërbimi Psiko-Social në DAR etj). Gjithashtu, DAR ka shprehur bashkëpunimin e hapur në mundësimin dhe lehtësimin e seancave informuese në shkolla 9 vjeçare dhe të mesme të Vlorës gjatë fushatave sensibilizuese.

Një nga kritikët, sidomos nga OJF-të, lidhet me numrin e kufizuar të psikologëve në shkolla për të përballuar fluksin e problemeve që nxënësit mund të kenë.

Bashkëpunimi me Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social konsiston në mbështetjen dhe ndërmjetësimin institucional në manaxhimin dhe trajtimin e rasteve. Specialistë të këtij institucioni janë gjithmonë pjesë aktive gjatë mbledhjeve të GTN.

Që prej vitit 2009 bashkia e Vlorës ka bashkëpunim të ngushtë me Qendrën “Vatra”, si e vetmja organizatë që ofron shërbime ligjore dhe psikologjike pa pagesë për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje, këto të fundit referohen nga koordinatorja pranë Qendrës Vatra.

Bashkëpunimi me OJF-të konsiston në aktivitete të ndryshme: trajnime, aktivitete për rritjen e ndërgjegjësimit dhe shërbime të drejtpërdrejta, si: informacion mbi procedurat dhe shërbimet në dispozicion, ndihmë ligjore falas, këshillim psikologjik, mbështetje shëndetësore, strehim, trajnime profesionale, ndërmjetësim për punësim, linjë këshillimi 24 orë falas etj.

Koordinatorja vendore ka referuar drejt Qendrës Vatra 38 raste viktime të dhunës për të cilat ka vlerësuar nevojën për informim, këshillim ose/dhe asistencë ligjore dhe këshillimi/ seanca psikologjike. Përgjithësisht, Llojet e çështjeve kanë qenë: marrja e UMM dhe UM në Gjykatë, procedim penal për dhunë dhe abuzim, zgjidhje martese, ndryshim/rritje e pensionit ushqimor për fëmijët, vendosje e fëmijës në kujdestari, kundërshtim/njohje atësie për të bërë më pas rregjistrimin e fëmijëve, regjistrim femije ne Gjendjen Civile, heqje e përgjegjësishë prindërore, vërtetim fakti juridik-lindjeje të fëmijëve të parregjistruar, ndreqje gabimi material në akt lindje apo çertifikatë lindje të fëmijëve, pavlefshmëri akt-lindje, vërtetim fakti juridik në marrëdhënie pune, etj.

Rastet janë asistuar dhe shoqëruar nga avokatët e qendrës në institucione të ndryshme si: Polici, Prokurori, Gjykatë, Zyra e Përmbarrimit, Zyra të Gjendjes Civile, Drejtoria e Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, Bashki, Shërbimi Social Shtetëror, Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, etj.

Gjithashtu, në bashkëpunim me Qendrën "Aulona", për përfitueset viktime të dhunës të akomoduar pranë strehëzës Vatra janë realizuar vizita dhe konsulta gjinekologjike pa pagesë.

Gjatë vitit 2019, Klinika Ligjore e Qendrës Vatra ka asistuar në total 291 viktime të dhunës, prej të cilëve:

- 170 vajza dhe gra viktime të dhunës janë këshilluar dhe asistuar në Gjykatë dhe institucione të tjera;
- 108 vajza dhe gra viktime të dhunës janë mbështetur me shërbim psikologjik;
- 37 vajza dhe gra janë mbështetur me shërbim ligjor dhe psikologjik.

Nga analiza bazuar në tabelën e mëposhtme, vlen të theksohet se rastet e paraqitura janë trajtuar sipas procedurave nga GTN-ja e Bashkisë Vlorë. Përveç mbledhjeve të GTN të realizuara pranë Drejtorisë së Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimeve Sociale, koordinatorja vendore ka realizuar mbledhjen e GTN edhe pranë Komisarariatit të Policisë Vlorë, në rastet emergjente ku është nevojitur ndërhyrja direktë për manaxhimin e rastit. Përgjatë vitit 2019 uj realizuan vetëm 6 mbledhje të GTN dhe asnjë mbledhje e Komitetit Drejtues të Mekanizmit të Referimit pranë kësaj bashkie.

Sipas raportimeve, pas muajit gusht nuk janë mbajtur mbledhje sepse nuk ka patur raste që kanë kërkuar menaxhimin nëpërmjet mbledhjeve të GTN-së por ato janë trajtuar duke nisur nga vlerësimi i nevojave deri tek referimi për shërbime.

Tabela 3. Numri i mbledhjeve të GTN-së në vitin 2019 në bashkinë Vlorë

Viti	Mbledhjet e GTN
2019	<p>18 prill 2019 – Mbledhja e GTN është realizuar për të diskutuar më detajisht rastin dhe për të ngritur një plan të hollësishëm ndërhyrje. Mbledhja u thirr nga koordinatori vendore dhe u zhvillua me praninë dhe angazhimin e specialistëve nga Shërbimi Social Rajonal, Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Bashkia Vlorë, Qendra Psiko-Sociale “Vatra” dhe Sektori i dhunës në familje dhe të miturve në Polici. U konceptua e tillë pasi u vlerësua nga koordinatori vendore se këta ishin aktorët që mund të ndërhyjnë në funksion të manaxhimit të rastit. Gjatë mbledhjes u diskutuan të gjitha alternativat për strehim afatgjatë të rastit dhe fëmijës (kjo ishte nevoja më emergjente). Akomodimi afatgjatë i rastit dhe fëmijës ose rikthimi i saj në familjen e origjinës ishin dy ndër çështjet kritike për diskutim. Rasti në fjalë u akomodua në situatë emergjence pranë Qendrës Vatra dhe ndoq dhe përfaqësua në vazhdimësi nga avokati i Vatrës gjatë marrjes së UM-së në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë.</p> <p>Në momentin e paraqitjes së gruas dhe fëmijës në polici, punonjësit e policisë kanë njoftuar koordinatorin vendore të dhunës, avokatin dhe psikologun e Vatrës. Ndërkohë, është hartuar në Komisarjat kërkesa për Urdhër Mbrojtje dhe është depozituar në Gjykatë. Në kërkesën për UM është shtuar klauzola “Është vlerësuar nevoja për akomodim pranë Qendrës Kombëtare të Trajtimit të Dhunës në Tiranë”.</p> <p>18 prill, në orën 14.20 pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë u zhvillua seanca për pajisjen me UM të rastit R.B. Rasti u asistua nga avokati i Qendrës “Vatra”. Si përfundim, gjyqetari vendosi pajisjen e gruas me UM por nuk pranoi vendosjen e tyre pranë Qendrës Kombëtare për Viktimat e Dhunës. Nga gjykata u vlerësua vendosja e rastit pranë familjes së origjinës. Deri në momentin e zbardhjes së vendimit të gjykatës, rasti do të qëndrojë e akomoduar pranë strehëzës Vatra. Zyra e Përmbarrimit ka vendosur kontakte me familjen e origjinës së gruas për rikthimin e saj në familje.</p> <p>Datë 19 prill, rreth orës 17.00 gruaja dhe djali i mitur janë shoqëruar nga përmbarrues të Zyrës së Përmbarrimit Vlorë në familje.</p>
2019	<p>4 maj 2019 - Mbledhja e GTN është realizuar për të diskutuar më detajisht rastin dhe për të ngritur një plan të hollësishëm ndërhyrje. Mbledhja u thirr nga koordinatori vendore dhe u zhvillua me praninë dhe angazhimin e specialistëve nga Shërbimi Social Rajonal, Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale Bashkia Vlorë, Qendra Psiko-Sociale “Vatra” dhe Zyra e Punës. U konceptua e tillë pasi u vlerësua nga koordinatori vendore se këta ishin aktorët që mund të ndërhyjnë në funksion të manaxhimit të rastit. Gjatë mbledhjes u diskutuan të gjitha alternativat për ushqim dhe punësim të viktimës.</p>
2019	<p>31 maj 2019 - U realizua takimi i Grupit Teknik Ndërsektorialku u diskutuan në vija të përgjithme problematika të hasura gjatë punës me viktimat e dhunës. Në fund të diskutimeve, u dha kontribut në plotësimin e një pyetësoringa UNDP lidhur me monitorimin e funksionimit të MRR në bashkinë Vlorë.</p>
2019	<p>26 qershor 2019 – Mbledhje e Grupit Teknik Ndërdisciplinar për manaxhimin e 2 rasteve dhe 6 fëmijët e tyre. Nisur nga fakti se rastet janë të shoqëruara me fëmijë, mbledhja është</p>

	zhvilluar nga Koordinatorja Vendore dhe Punonjësi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve në bashkinë Vlorë. Takimi u realizua me kërkesë të Vatrës, pas ngritjes së shqetësimit nga nëna e 4 fëmijëve të mitur për pamundësi financiare për kujdesin dhe mirërritjen e fëmijëve. Gjatë këtyre muajve, familja është mbështetur me shërbime direkte nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijëve, Vatra dhe Drejtoria e Ndhmës dhe Shërbimeve Sociale në bashkinë Vlorë për pagesë financiare për banesë me qera, mbështetje financiare për plotësim të nevojave bazike (ushqim, veshmbathje, etj), regjistrim në institucionet arsimore për fëmijët, regjistrim dhe përfshirje e fëmijëve për frekuentim pa pagesë (me të ardhurat e bashkisë) në çerdhe, etj.
2019	Korrik 2019 - Koordinatorja vendore së bashku me Njësinë e Mbrojtjes së Fëmijëve në bashki dhe psikologun e Vatrës kanë ndjekur dhe manaxhuar një rast viktimë dhune dhe fëmijën e saj të mitur. Janë mbajur kontakte të vazhdueshme me Policinë dhe Zyrën e Përmbarrimit nëpërmjet dërgimit të shkresave zyrtare për kthimin e të miturës pranë nënës dhe marrjen e masave nga institucionet lokale përgjegjëse, pasi vajza mbahej nga i ati dhe gjyshja kundër vendimit të gjykatës. Në dijeni u vendos edhe Shërbimi Social Shtetëror. Punonjës të bashkisë dhe psikologu i Qendrës Vatra, efektivë dhe përfaqësues të policisë, përfaqësues të Zyrës së Përmbarrimit dhe Prokurorisë dhe Kryetarja e Rajonit kanë qenë pjesë e grupit të punës në kohën e ekzekutimit të gjykatës në banesë.
2019	Gusht 2019 - U realizua takimi i Grupit Teknik Ndërsektorialku u diskutuan mbi sfidat e hasura në trajtimin dhe referimin e viktimave të dhunës, në përmbyllje të 6 mujorit të parë të vitit.

Burimi: Bashkia Vlorë

Tabela 4. Këshilli Drejtues i MRR-së Bashkia Vlorë, 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Dritan Leli
Drejtoria e Policisë	Gentjan Shehaj
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Skënder Haluci
Prokuroria e Rrethit	Ardian Ylli
Zyra Arsimore Rajonale	Alma Bakiu
Drejtoria e Shëndetit Publik	Myzafer Islami
Zyra e Përmbarrimit	Fitim Koçaj
Prefektura	Flamur Mamaç
Zyra Rajonale e Punësimit	Saniela Xhaferi
Qendra Psiko-Sociale “Vatra”	Brikena Puka
Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror Vlorë	Eno Koleka
Spitali Vlorë	Brunilda Mersini
Mjeku Ligjor	Blerim Peli
Qendra “Aulona”	Enela Mone

Tabela 5. GTN-ja e bashkisë Vlorë viti 2019

Institucioni	Emër mbiemër i përfaqësuesit në vitin 2019
Bashkia	Irena Stasa, Rezarta Andoni
Drejtoria e Policisë	Silvana Ngresi
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Rezarta Taushani
Prokuroria e Rrethit	Nuk janë prezent
Drejtoria Arsimore Rajonale	Iris Mitro
Drejtoria e Shëndetit Publik	Florina Hajrulla
Zyra e Përmbartimit	Nuk janë prezent
Prefektura	Nuk janë prezent
Kryetarët e Njësisë Administrative	Elisabeta Merkohitoj; Arzika Nezha; Afize Selman Hasko; Edlira Ferataj; Ruxha Xhaferi
Zyra e Punësimit	Gjinovefa Xhori
Qendra Psiko-Sociale “Vatra”	Malvina Aliaj, Oliana Manaj
Strehëzat për viktimat e dhunës	Nuk ka
Komunitete fetare	Nuk ka
Dhoma e Avokatisë së Rrethit	Nuk janë prezent

Burimi: Bashkia Vlorë

Sic vërehet nga tabela, mungon prezenca dhe bashkëpunimi me Zyrën e Përmbartimit, Spitalin Rajonal Vlorë dhe Mjekun Ligjor. Në këto kushte, janë gjetur rrugë alternative bashkëpunimi me këto institucione, siç është komunikimi nëpërmjet telefonit apo email.

Si pikë e fortë në Bashkinë Vlorë vlen të përmendet qëndrueshmëria (mosndërrimi i shpeshtë) e specialistëve që përfaqësojnë institucionet në këto mbledhje dhe prania (ushtrimi i aktivitetit) e organizatave joqeveritare të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.

Nga statistikat e siguruar nga bashkia Vlorë, Drejtoria Vendore e Policisë Vlorë dhe Qendra “Vatra” për vitin 2019 rezulton se Urdhërat e Mbrojtjes dhe Urdhërat e Menjëhershëm të Mbrojtjes plotësohen nga Specialistë pranë Drejtorisë Vendore të Policisë së Qarkut Vlorë. Gjatë vitit specialistë të Qendrës “Vatra” kanë hartuar 10 kërkesë padi, prej të cilave 8 kërkesë-padi për Urdhër Mbrojtje dhe 2 për Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje.

Përgjatë vitit 2019, me referim të Strehëzës kombëtare për viktimat e dhunës në familje, pas largimit të rastit nga strehëza dhe kthimit në jetesë të pavarur në Vlorë, koordinatoresha vendore ka monitoruar një viktimë të dhunës dhe fëmijën e saj të mitur. Menjëherë koordinatoresha vendore i dhunës dhe punonjësi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve vlerësuan dhe monitoruan familjen. Përfutjesja u informua dhe u drejtua mbi hartën e shërbimeve mbështetëse dhe u ndërmjetësua në vazhdimësi.

Objektivi 3.3: Ndëshkimi I dhunuesve dhe dhënia e mundësisë për rehabilitimin e tyre, përmes programeve të specializuara.

Ka një sërë shërbimet që mungojnë në bashkinë Vlorë, por një ndër më kryesorët mbetet rehabilitimi i dhunuesve përmes programeve të specializuara. Mungesa e linjës së këshillimit/qendër rehabilitimi për dhunuesit burra; qendër e specializuar shërbimesh për viktimat e dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor që paraqesin nevoja urgjente për strehim. Bashkia Vlorë nuk ofron shërbime këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues. Në territorin e Bashkisë nuk operojnë organizata të specializuara që ndjekin programe rehabilituese për dhunuesit. E vetmja strukturë që ofron shërbime këshillimi për djemtë dhe burrat dhunues është Klinika Ligjore e Qendrës Psiko-Sociale “Vatra”.

Në këtë kuadër, shërbimi për rehabilitimin e burrave dhunues ofrohet në kuadër të projektit "Donne e Uomini - Liberi dalla violenza in Albania", financuar nga Centro Informazione e Educazione allo Sviluppo ONLUS (CIES), me kohëzgjatje 1 Tetor 2019 - 30 Shtator 2022.

Ky shërbim u ofrohet të gjithë burrave dhe djemve që kanë ushtruar dhune fizike, psikologjike apo seksuale në familje. Detyra e këtij shërbimi është të krijojë dhe ofrojë një plan këshillimi afatgjatë për dhunuesit, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe në rritjen e sigurisë për viktimat e dhunës. Qëllimi i shërbimit synon eksplorimin e sjelljeve të reja që e largojnë abuzuesin nga dhuna në familje, me qëllimin final krijimin e një ambjenti pa dhunë në familjet ku personat jetojnë, me fokus të veçantë krijimin e ambienteve të sigurta për viktimat e dhunës. Pjesë e rëndësishme e këtij shërbimi është dhe parandalimi nëpërmjet edukimit dhe informimit të të rinjve dhe komunitetit (me fokus të veçantë djemtë) rreth problematikave të dhunës në familje.

Nga data 1 Nëntor 2019, pranë Klinikës Ligjore të Qendrës Psiko-sociale “Vatra” ofrohet shërbim për këshillim të burrave dhe djemve dhunues. Ky shërbim u ofrohet të gjithë burrave dhe djemve që kanë ushtruar dhune fizike, psikologjike apo seksuale në familje.

Detyra e këtij shërbimi është të krijojë dhe ofrojë një plan këshillimi afatgjatë dhunuesit, duke ndikuar në mënyrë të drejtëpërdrejtë dhe në rritjen e sigurisë për viktimat e dhunës.

Qëllimi i shërbimit synon eksplorimin e sjelljeve të reja që e largojnë abuzuesin nga dhuna në familje, me qëllimin final krijimin e një ambjenti pa dhunë në familjet ku personat jetojnë, me fokus të veçantë krijimin e ambienteve të sigurta për viktimat e dhunës.

Pjesë e rëndësishme e këtij shërbimi është dhe parandalimi nëpërmjet edukimit dhe informimit të të rinjve dhe komunitetit (me fokus të veçantë djemtë) rreth problematikave të dhunës në familje.

Gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2019 janë mbështetur me këshillim dhe asistencë psikologjike në total **9 raste**, prej të cilëve:

- 1 dhunues në familje
- 2 (djem) viktimat e dhunës të pajisur me Urdhër të Menjëhershëm Mbrojtje
- 6 dhunues gjatë procesit të vlerësimit në çështjen civile “Zgjidhje martese” dhe “Lënie për rritje dhe edukim”.

Rastet janë referuar nga Klinika Ligjore e Qendrës "Vatra" dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Me 9 përfituesit janë zhvilluar seancat e para të këshillimit, që kanë konsistuar në vendosjen e kontakteve, prezantimin e historikut dhe problematikave, prezantimin e shërbimit dhe metodologjisë për ndjekjen e seancave të këshillimit dhe shprehjen e dakortësisë për ndjekjen e tyre. Seancat realizohen në trajtën e këshillimeve individuale (afatagjata).

Në vijim, bashkëpunimi me Zyrën e Përmbarrimit dhe bashkisë Vlorë mungon totalisht. Nuk ka pasur asnjë lloj bashkëpunimi/shkëmbim informacioni. Përgjatë vitit 2019 kjo zyrë rajonale ka egzekutuar 5 raste me objekt "UMM" raste që kanë pasur nevojë për ndërhyrjen e zyrës së përmbarrimit, në vijim po kjo zyrë ka egzekutuar 129 raste me objekt "takim fëmije" dhe 204 raste me objekt "pension ushqimor"⁵. Nuk kanë qenë prezent në asnjë takim, situatë kjo e njëjtë edhe me vitet e kaluara.

Rekomandime

Në bazë të monitorimit të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore në bashkinë e Vlorës për vitin 2019, më poshtë renditen disa rekomandime për përmirësimin e punës së funksionimit të Mekanizmit të Referimit kundër Dhunës me bazë gjinore në Bashkinë Vlorë dhe adresimin e objektivit të tretë të SKBGJ (2016-2020), kundër dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.

- Rekomandohen trajnime të përbashkëta të anëtarëve të Mekanizmit të Referimit Vlorë, në mënyrë që të përfitohet Identifikimi i hershëm; Te kuptuarit e njëjtë të rriskut dhe trajtimin e rasteve të dhunës në familje.
- Bashkia Vlorë duhet të parashikojë një zë të veçantë në buxhetin e bashkisë për mirëfunksionimin e mekanizmit të referimit për për ta mbështetur me materiale promovuese si dhe duhe të alokojë buxhet dedikuar mirëfunksionimit dhe veprimtarisë së MKR.
- Duhet vendosur në mënyrë emergjente marrëdhënia me Zyrën e Përmbarrimit, Spitalin e Pwrgjithshwm Vlorw dhe Mjekun Ligjor, institucione këto me të cilat bashkëpunimi mungon.
- Bashkia Vlorë vazhdon të paraqesë të njëjtat nevoja emergjente për manaxhimin e suksesshëm të rasteve të dhunës: mungesa e banesave sociale për strehim dhe akomodim të rasteve viktime të dhunës; mungesa e një mjete transporti në manaxhimin e bashkisë për transportin fizik të viktimave të dhunës në qendra të specializuara. Për këto arsye, rekomandohet adresimi dhe gjetja e zgjidhjeve imediate.
- Një qendër e specializuar shërbimesh për viktimat e dhunës në familje me probleme të shëndetit mendor që paraqesin nevoja urgjente për strehim është një tjetër rekomandim për bashkinë Vlorë.

⁵ Burimi: Drejtorja e Përgjithshme e Përmbarrimit

- Duhet përshëndetur dhe marrë si shembull edhe nga bashkitë e tjera qëndrueshmëria (mos-ndërrimi i shpeshtë) e specialistëve që përfaqësojnë institucionet në këto mbledhje dhe prania (ushtrimi i aktivitetit) e organizatave joqeveritare të specializuara në ofrimin e shërbimeve për viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare.
- Edhe pse rastet e viktimave të dhunës në familje ndiqen në mënyrë të rregullt nga koordinatori vendore dhe anëtarët e mekanizmit, mbledhja e GTN-së duhet të mbahet më e shpeshtë dhe më e rregullt.
- Komiteti Drejtues pranë kësaj bashkie rekomandohet që të planifikojë dhe të organizojë mbledhje siç parashikon edhe ligji.
- Numri i kufizuar i psikologëve në shkolla për të përballuar fluksin e problemeve që nxënësit mund të kenë, sidomos nxënës që vijnë nga familje me probleme dhune duhet adresuar.
- Punësimi i grave apo/dhe vajzave të dhunuara mbetet një problematikë e gjerë e cila duhet adresuar, sidomos për ato viktime të cilave ju mungon formimi profesional.